

**Energy Regulatory Office
Zyrja e Rregulatorit të Energjisë Elektrike
ERO, UNMIK-EU Pillar**

**29th June 2005
29 Qershor 2005**

ZRE, UNMIK – Shtylla e UE-s

Bajram Kelmendi St. No. 75

Rr. Bajram Kelmendi nr. 75

38000, Prishtina, Kosovo

Ref: 05-01-03-77

Attention/Për Mr/z. Nick F Frydas

Subject: Service connection procedure and prices

Lënda: Procedurat dhe çmimet e shërbimit të kyqjeve

Sir/ Zotëri i nderuar

We hereby submit a revised application referred to above with the necessary justification for your comments.

Ju dorëzojmë aplikacionin e rishikuar lidhur me qeshtjën e lartpërmendur së bashku me arsyetimin e domosdoshëm të komenteve tuaja

We thank you in advance

Ju falenderojmë

Yours sincerely

I juaji,



Francois Pienaar,

Director of Supply / Drejtor i Furnizimit

Cc/kopje për: Mr/z.. John Ashley, KEK, Managing Director/Drejtor Menaxhues
Mr/z. Sean McGoldrick, KEK, Executive Director Commercial & Regulatory/ Drejtor
Executiv i KEK-ut për Komerçiale & rregulativë
Mrs/znj. Sherife Avdyli, KEK, Manager Regulatory Division / Menaxhere e Divizionit të
KEK-ut për Rregullativë
Mrs/znj. Fellanze Pula, Manager Supply / Menaxhere e Furnizimit
Mrs/znj. Merita Kostari, ERO / ZRE
Mr/z. Naim Bejtullahu, ERO / ZRE
Mr/z. Azem Kastrati, ERO / ZRE

1 SUMMARY OF STRATEGY / PËRMBLEDHJE E STRATEGJISË

1. The main objective of this Strategy is register anyone applying to become an authorised Customer irrespective of the period of time the Customer was connected to the KEK network.

Qëllimi kryesor i kësaj Strategjie është regjistrimi i të gjithë atyre që aplikojnë të bëhen Konsumatorë të autorizuar pa marrë parasyshë periudhën kohore kur Konsumatori është kyqur në rrjetin e KEK-ut.

2. The policy of KEK not to execute service connections means that when a Customer applies to be registered with KEK, this Customer is already connected to the network. It is therefore difficult for the Customer services department to establish if a Customer was connected to the network recently (new service connection) or for a longer period of time (Illegally connected). The only way to determine if a Customer was connected for a long period of time is if KEK sends a team to take a meter reading and establish if energy consumed indicates long term consumption, this is the procedure used to date. This policy is flawed because KEK cannot establish what the meter reading was when the Customer started consuming energy and therefore cannot accurately calculate energy for which the customer was not billed.

Politika e KEK-ut për mos ekzekutimin e shërbimit të kyqjes nënkupton atë se kur një Konsumator aplikon për t'u regjistruar në KEK, i njëjti Konsumator veq është i kyqur në rrjetë. Prandaj, është vështirë për departamentin e Shërbimit ndaj Konsumatorëve të vendos nëse një Konsumatorë i caktuar është kyqur në rrjetë kohëve të fundit (kyqje e re) apo për një periudhë më të gjatë (kyqje ilegale). E vetmja rrugë për të caktuar nëse një konsumatorë është kyqur për një periudhë të gjatë është nëse KEK-u dërgon ekipin e vet për t'i lexuar njuhësorin dhe të shohë nëse energjia e konsumuar tregon një hargjim afatgjatë. Kjo është procedura që është përdorur deri tani. Kjo politikë i ka të metat e veta sepse KEK-u nuk mund të vendos se çfarë ka qenë gjendja e njuhësorit në kohën kur Konsumatori ka filluar konsumin e energjisë elektrike prandaj nuk mundet që të llogarisë me saktësi energjinë për të cilën konsumatori nuk është faturuar,

3. This strategy will attract not only new Customers but also Customers already connected to the Network to register with KEK. This strategy is designed to allow any Customer to register with KEK and employs procedures that are fair; auditable and can stand up in court if challenged. The Public Information campaign will clearly state that if a Customer is caught with an unauthorised connection to the Network, then the charges for unauthorised consumption will be applied. This strategy is designed to entice Customers to come to KEK and not for KEK to go and find them. This will solve a resource limitation KEK has at present and will allow disconnections and prosecutions to be focused towards debtors. The Public Information campaign will state that KEK's disconnection capacity will be increased and will be focused towards illegal Customers towards the beginning of winter, therefore **now** is the time to register.

Kjo strategji do t'i tërheqë të regjistrohen në KEK jo vetëm Konsumatorët e rinjë por edhe Konsumatorët tanimë të kyqur në Rrjet. Kjo strategji është e dizajnuar që t'i mundësojë çdo Konsumatori të regjistrohen në KEK dhe të shfrytëzojë procedurat të cilat janë të drejta, të auditueshme dhe mund të mbrohen në gjykata në rast të kontestimit të tyre. Fushata e

*Informimit Publik qartë do të theksojë se në rast se Konsumatori zihet të jetë kyqur pa autorizim në Rrjet atëherë do të aplikohen ngarkesat për konsum të pa autorizuar. Kjo strategji është dizajnuar që të tërheqë Konsumatorët të vijnë në KEK e jo KEK-u t'i gjejë ata. Kjo do të zgjidhë problemin e kufizimeve në burimet e duhura që KEK-u ka në këtë kohë si dhe do t'i mundësojë shërbimit të shkyqjeve dhe ndjekjeve të përqëndrohen në borgjlinjë. Kampanja e informimit public do të theksojë se kapacitetet e shkyqjeve të KEK-ut do të rriten dhe do të përqëndrohemi drejt Konsumatorëve illegal deri në fillim të dimrit prandaj **tani** është koha të regjistrohen*

4. This strategy will gain KEK time to develop the Networks divisions that are responsible for service connections and infrastructure expansion and at the same time will increase billing.

Kjo strategji do t'i jep kohë KEK-ut të zhvillojë divizionet e Rrjetit përgjegjëse për shërbimin e kyqjeve dhe zgjerimin e infrastrukturës si dhe rritjen e faturimit në të njëjtën kohë.

2 SERVICE CONNECTION / SHËRBIMI I KYQJEVE

The service connection charges proposed by ERO are included in this application. We hereby submit an outline of the application procedure (Section 2.1) and the revised charge structure (Section 2.3).

Në këtë aplikacion janë përfshirë edhe ngarkesat për shërbimin e kyqjeve të propozuara nga ana e ZRE. Përmes kësaj ne po dorëzojmë përmbledhjen e procedurave të aplikimit (seksioni 2.1) dhe strukturën e rishqyrtuar të ngarkesave (seksioni 2.3).

2.1 Procedure / Procedura

1. The Customer applies for a service connection through the Supply Division.

Konsumatori aplikon për shërbim të kyqjes përmes Divizionit të Furnizimit.

2. A Customer only pays the application processing fee (Section 2.3.1.1; 2.3.2.1 & 2.3.3.1) when the Customer submits an application. The Customer will indicate on the application form after which date the service connection can be inspected.

Konsumatori paguan vetëm çmimin për shqyrtimin/procesimin të aplikacionit (seksioni 2.3.1.1; 2.3.2.1 & 2.3.3.1) kur ai ajo e dorëzon aplikacionin. Konsumatori do të tregojë në aplikacion se pas cilës date mund të bëhet inspektimi i kyqjes.

3. The Customer will be registered on the billing system as a temporary Customer.

Konsumatori do të regjistrohet në sistemin e faturimit si një Konsumator i përkohshëm.

4. The application is forwarded to the Networks division that will inspect the supply infrastructure. The meter will be checked, sealed and registered.

Aplikacioni i dërgohet divizionit të Rrjetit i cili do të inspektojë infrastrukturën e furnizimit.. Do të kontrollohet njëhësori, do të plombohet dhe regjistrohet.

5. The Customer will be ordered on the meter reading route.

Konsumatori do të renditet në shtegun përkatës të leximit.

6. If the Customer has no meter, KEK will charge the Customer on the flat rate tariff. KEK will be installing meters during the course of the year and will target flat rated Customers first.

Nëse Konsumatori nuk ka njuhësor, KEK-u do të ngarkojë atë me paushall. KEK-u do t'i instalojë njuhësorin gjatë vitit dhe fillimisht për cak do të ketë Konsumatorët me paushall.

7. When the Customer is approved by the KEK Networks Division the Customer will be invited to sign a Supply Contract with KEK. If the networks division rejects an installation; then the Customer will be offered a temporary Supply contract. The only difference between the permanent Supply Contract and temporary Supply Contract will be the following sentence added to the existing Supply Contract document issued by KEK:

Kur nga ana e Divizionit të Rrejt Konsumatori është miratuar, Konsumatori do të ftohet të nënshkruajë Kontratën për Furnizim me KEK-un. Nëse divizioni i rrejt refuzon instalimin atëherë Konsumatorit do t'i ofrohet kontratë e përkohshme e Furnizimit. I vetmi ndryshim mes Kontratës së Përhershme dhe asaj të Përkohshme të Furnizimit do të jetë fjalia në vijim e cila do t'i shtohet Kontrates ekzistuese për Furnizim të lëshuar nga ana e KEK-ut:

- Heading / Titulli:

“Contract for Electricity Service” Will be changed to “Temporary 6 month contract for Electricity Service”

“Kontratë për Shërbime të Energjisë Elektrike” do të ndryshohet në “Kontratë e përkohshme 6 mujore për Shërbime të Energjisë Elektrike”

- Limitations: Part three will be added / Kufizimet: Do të shtohet pjesa e tretë:

“Until such time that the service connection is upgraded in compliance with the technical standards of KEK, KEK will not guarantee or be held responsible for the quality of supply of electricity”

“Deri atëherë kur shërbimi i kyqjes të ngritet në pajtim me standardet teknike të KEK-ut, KEK-u nuk do të garantojë apo bartë përgjegjësi për kualitetin e furnizimit me energji elektrike”

8. If the Customer is not approved by the KEK Networks Division and the installation is safe, then the Customer will be informed of the following steps to be taken / Në rast se Konsumatori nuk është miratuar nga ana e divizionit të Rrejt të KEK-ut dhe instalimi është i sigurt atëherë Konsumatori do të informohet mbi hapat e mëposhtëm që duhet ndërmarrë:

- The minimal technical standards required for a service connection if the Customer wants to correct the service connection will be made available to the Customer within 6 months or KEK will quote the Customer for the work to be completed to upgrade the installation.

Standardet minimale teknike që kërkohen për një kyqje nëse Konsumatori dëshiron të përmirësojë kyqjen. Këto standarde do të jenë në dispozicion Konsumatorit mbrenda 6 muajsh apo KEK-u do të caktojë vlerën e punëve që duhet kryer për përmirësimin e instalimit dhe do t'i dorëzojë Konsumatorit.

- KEK will quote the Customer for the work to be executed. The Customer may apply to pay off this amount over a period of time not exceeding 12 months.

KEK-u do të jep ofertën Konsumatorit për punët që duhet ekzekutuar. Konsumatori mund të aplikojë që këtë shumë paguajë gjatë një periudhe kohore e cila nuk kalon 12 muajshin.

- The service connection must be corrected within 12 months; otherwise the Customer will be disconnected.

Kyqja duhet të korrigohet mbrenda 12 muajsh; përndryshe Konsumatori do të shkyqet.

- Only when the service connection has been approved by the Networks Division will the Customer be asked to sign a Supply Contract with KEK.

Vetëm kur kyqja të jetë miratuar nga ana e divizionit të Rrjetit, do të kërkohet nga ana e Konsumatorit të nënshkruajë Kontratën për Furnizim me KEK-un.

9. If the Customer is not approved by the KEK Networks Division due to an unsafe installation; then the Customer will be disconnected.

Nëse Konsumatori nuk është miratuar nga ana e divizionit të Rrjetit për shkak të instalimit jo të sigurt, atëherë Konsumatori do të shkyqet.

10. If a customer requests from KEK to expand the Network it may be allowed only if the customer pays for such expansion and where it is technically and economically feasible.

Nëse një konsumatorë kërkon nga KEK-u të zgjerojë Rrjetin, kjo mund të lejohet vetëm nëse konsumatori paguan për atë zgjerim dhe atje ku teknikisht dhe ekonomikisht është i mundshëm

2.2 Networks capacity (Paragraph-e in the letter from ERO) / Kapaciteti i Rrjetit (paragrafet nga letra e ZRE)

1. KEK's Networks Division can reasonably identify substations with 10kV feeders that are over loaded at present where the load is exceeding the design capacity of equipment. The majority of feeders fall in this category. In areas where the 10kV Medium Voltage system is overloaded, KEK will publish the areas on the KEK Website over the course of the next few months (Before December 2005)

Divizioni i rrjetit të KEK-ut mund të identifikojë nënstacionet me dalje 10kV të cilat janë të mbingarkuara, për momentin ku ngarkesa tejkalon kapacitetin e dizajnuar të pajisjeve. Shumica e daljeve i përkasin kësaj kategorije. Pjesët ku sistemi me Tension Mesatar 10kV është mbingarkuar, KEK-u do të publikoj zonat në Faqen e Internetit të vet në rrjedhën e muajve të ardhshëm (para dhjetorit 2005)

2. Completing a technical evaluation of the 0.4kV Feeders on the whole system will be a major project that will require a considerable amount of test equipment and KEK resources.

Përfundimi i vlerësimit teknik të daljeve 0.4 kV në të gjithë sistemin do të jetë një projekt i madh që kërkon pajisje të konsiderueshme testimi dhe burime të duhura nga KEK-u.

3. It is more reasonable for KEK to assess network conditions when applications for service connections are submitted and then through this process to eliminate 0.4kV feeders that are found to be overloaded.

Është më e arsyeshme për KEK-un të vlerësojë kushtet e rrjetit kur dorëzohen aplikacionet për kyqje dhe përmes këtij procesi të eliminojë daljet 0.4 kV të cilat kuptohët të jenë të mbingarkuara.

4. These feeders will be recorded and the information will be made available to the public on an area per area basis on the KEK Website

Këto dalje do të regjistrohen dhe do të bëhen publike opinionit përmes Faqes së Internetit të KEK-ut sipas vendeve.

2.3 Service connection charges / Ngarkesat e kyqjeve

2.3.1 Charges for a 0.4kV <= 60A 3-phase Service connection / Ngarkesat për një kyqje 0.4 kV <= 60A 3 - fazore

This category is applicable to Customers applying for a 3 phase 0.4kV supply equal to or less than 60A.

Kjo kategori ka të bëjë me Konsumatorët që aplikojnë për furnizim trefazor 0.4 kV të barabart apo më pak se 60A.

2.3.1.1 Application processing fee / Pagesa e shqyrtimit të aplikacionit: (€30)

This amount will be charged to the Customer when the Customer applies for service connection.

Kjo shumë do t'i ngarkohet Konsumatorit kur ai/ajo aplikon për kyqje.

2.3.1.2 Customers requiring KEK to do the installation for a new supply / Konsumatori që kërkon nga KEK-u ta bëjë instalimin për furnizim të ri:

1. Installation fee / pagesa për instalim (€390)

- Standard charge for LV customers requiring 60A 3-phase supply within 60m of existing LV Network for underground supply (customer to provide duct), or within 30m of existing LV Network for overhead supply.

Ngarkesa standarde për konsumatorët e TU që kërkojnë furnizim tre fazor 60A mbrenda 60m të Rrjetit ekzistues TU për furnizim nëntokësor (konsumatori të mundësojë gypat), apo mbrenda 30 m të rrjetit ekzistues të TU për furnizim me lartpërçues.

- Cost structure made up as follows / Struktura e kostove si vijon:

Cable / Kabëll:	€100
Meter kiosk / Shtëpiza e njehësorit:	€223
Total Material / Materiali në total:	€323
Labour (Meter box installation): Puna (instalimi i shtëpizës së njehësorit)	€37

Labour (Cable connection):	€30
Puna (Lidhjen e kablllove):	
Total:	€30

2. For customers outside distance limits additional costs will apply.

Për konsumatorë jashtë distances së kufizuar do të aplikohen shpenzime shtesë.

- ~~3. For customers requiring enhanced supply up to 60A additional costs will apply.~~

4. For customers providing their own metering installation (to KEK standards) this charge will reduce to (€130).

Për konsumatorët që mundësojnë vet instalimin e njehësorëve (sipas standardeve të KEK-ut), kjo ngarkesë do të zvoglohet në (€130).

Cable / Kabbloja:	€100
Labour (Cable connection):	€30
Puna (lidhja e kablllos):	
Total:	€130

5. Above charges are based on cost of customers' dedicated assets only. They do not include shared asset charges or capacity charges which, it is assumed, will be recovered by the tariff.

Ngarkesat e mësipërme janë bazuar vetëm në kostot e mjeteve themelore të dedikuara për konsumatorë. Ato nuk përfshijnë ngarkesat e mjeteve të përbashkëta apo ngarkesat e kapacitetit për të cilat supozohet se janë mbuluar nga tarifat.

6. KEK will operate and maintain all meter installations, service connections and networks

KEK-u do të operojë dhe mirëmbajë të gjitha instalimet e njehësorëve, kyqjes dhe rrejtit.

2.3.1.3 Customers providing their own installations / konsumatorët të cilët mundësojnë instalimin e vet:

1. Installation inspection fee / pagesën për inspektimin e instalimit(€20).
2. Fee for new installation, as above if existing installation is not technically acceptable / Pagesa për instalimin e ri, si më lartë në rast se instalimi nuk është i pranueshëm teknikisht (Section 2.3.1.2).
3. Re-inspection fee if customer opts to modify defective installation. / Pagesa e ri-inspektimit në rast se konsumatori zgjedh të menjanojë të metat në instalim (€15).

2.3.2 Charges for a 0.4kV > 60A 3-phase Service connection / Ngarkesa për kyqje 3-fazore 0.4kV > 60A

This category is applicable to Customers applying for a 3 phase 0.4kV supply exceeding 60A.

Kjo kategori aplikohet ndaj Konsumatorëve që aplikojnë për furnizim 3 – fazor 0.4 kV që e kalojnë 60A.

2.3.2.1 Application processing fee / Pagesa e shqyrtimit të aplikacionit: (€30).

This amount will be charged to the Customer when the Customer applies for a service connection or asks KEK to prepare a quote for the construction of supply infrastructure for a Customer.

Kjo shumë do t'i ngarkohet Konsumatorit kur ai/ajo aplikojnë për kyqje apo kërkojnë nga KEK-u që të pregadisë ofertën për ndërtimin e infrastruktures së furnizimit për një Konsumator.

2.3.2.2 Customers requiring KEK to do the installation for a new supply / Konsumatori kërkon nga KEK-u ta bëjë instalimin e një furnizimi të ri:

KEK will prepare a quote for the Customer and will reflect the cost in the quote.

If the load exceeds 60A then networks will prepare a quote that will include the required metering infrastructure appropriate for this amperage. If the load exceed 150A 3 phase then the Customer will be informed that supply can only be provided at a higher voltage level and the procedure in **section 2.3.3** will be followed.

KEK-u përgatitë ofertën për Konsumatorin ku do të reflektohen kostot e ofertës.

*Nëse ngarkesa tejkalon 60A atëherë rrjeti do të përgatitë një ofertë e cila përfshinë infrastrukturën e kërkuar të njehësimit të përshtatshme për këtë amperazhë. Nëse ngarkesa tejkalon 150A, 3 fazat, atëherë Konsumatori do të informohet që furnizimi mund të bëhet vetëm në një nivel më të lartë të tensionit dhe sipas procedurës në **seksionin 2.3.3***

2.3.2.3 Customers providing their own installations / Konsuamtori i cili siguron instalimin e vet:

1. Installation inspection fee / pagesa e inspektimit të instalimit(€20).
2. Fee for new installation (Section **2.3.2.2**), as above if existing installation is not technically acceptable.

*Pagesa për instalim të ri (seksioni **2.3.2.2**), si më lartë, nëse instalimi ekzistues nuk është i pranueshëm teknikisht.*

3. Re-inspection fee if customer opts to modify defective installation

Pagesa e ri-inspektimit në rast se konsumatori zgjedh të rregulloj të metat e instalimit. (€15).

2.3.3 Kyqjet / 6, 10, 35 & 110kV Service connection

This category is applicable to Customers applying for a 3 phase 0.4kV supply exceeding 60A and for supplies at all voltage exceeding 0.4kV.

Kjo kategori është e aplikueshme për Konsumatorë të cilët aplikojnë për furnizim 3-fazor 0.4 kV që tejkalojnë 60A si dhe furnizimet me tension që tejkalojnë 0.4 kV

2.3.3.1 Application processing fee / Pagesa e shqyrtimit (përpunimit) të aplikacionit: (€ 180).

This amount will be charged to the Customer when the Customer applies for a service connection or asks KEK to prepare a quote for the construction of supply infrastructure for a Customer. If the Customer had paid €30 during an application for a 0.4kV Supply then the Customer only needs to pay the balance of €150.

Kjo shumë do t'i ngarkohet Konsumatorit kur ai/ajo aplikon për kyqje apo kërkon nga KEK-u të përgatitë ofertën për ndërtim të infrastructures furnizuese për një konsumatorë. Nëse Konsumatori ka paguar € 30 gjatë aplikimit për furnizim 0.4kV atëherë Konsumatori nevojitet të paguaj vetëm pjesën e mbetur prej € 150.

2.3.3.2 Customers requiring KEK to do the installation for a new supply / Konsumatorët që kërkojnë nga KEK-u të bëjë instalimin për një furnizim të ri:

KEK will prepare a quote for the Customer and will reflect the cost in the quote.

KEK-u do të përgatitë një ofertë për Konsumatorin ku do të reflektohen edhe kostot përkatëse.

2.3.3.3 Customers providing their own installations / Konsumatorët që e mundësojnë instalimin e vet:

1. Installation inspection fee / Pagesa e inspektimit të instalimit (€100).
2. Fee for new installation (Section 2.3.3.2), as above if existing installation is not technically acceptable.

Pagesa për instalim të ri (seksioni 2.3.3.2), si më lartë, nëse instalimi ekzistues nuk është i pranueshëm teknikisht.

3. Re-inspection fee if customer opts to modify defective installation

Pagesa e ri-inspektimit nëse konsumatori zgjedh të menjanojë të metat e instalimit. (€70).

2.3.4 Payment terms / Kushtet e pagesës:

1. Cash payment in full for application processing and inspection fee.

Pagesa e tërë në para të gatshme për shqyrtimin e aplikacionit dhe pagesën e inspektimit

2. Above are interim charges only will be reviewed annually and following tariff reviews.

Më lart janë ndryshimet e përkohshme që do të shqyrtohen në baza vjetore dhe sipas shqyrtimeve të tarifave.